



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 12.07.2017

Ref.: 620/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e BPrAL Kolegji “UBT” për njohje të akreditimit për programin e studimit: Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja, MA, 120 ECTS, program ky i akredituar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditim në Austri, sipas kushteve të dhëna nga kjo agjenci.
- II. Periudha e njohjes së akreditimit për programin e cekur në pikën një (I) të këtij vendimi është pesë vjeçare, përkatësisht 1 tetor 2017 – 30 shtator 2022.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “UBT” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për njohje të akreditimit të programit të studimit: Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja, MA, 120 ECTS.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka vlerësuar kërkesën e BPrAL Kolegji “UBT”, dhe pas shqyrtimit të sajë dhe dokumenteve të tjera të bashkangjitura, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Programi i studimit i cekur në pikën një të këtij vendimi, është akredituar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditim në Austri, si projekt i përbashkët i këtyre institucioneve: Universiteti i Salzburgut (Austri), Universiteti i Tiranës (Shqipëri), Universiteti Evropian i Tiranës (Shqipëri), Universiteti i Sarajevës (Bosnje dhe Hercegovinë), Shkolla për Shkencë dhe Teknologji në Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë), Kolegji Fama (Kosovë), Kolegji UBT (Kosovë), Universiteti Cyril dhe Methodius (Maqedoni), dhe Universiteti i Lubjanës (Slloveni).


Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, neni 3, pika 16, sipas të cilit organ akreditues përveç Agjencisë së Kosovës për Akreditim janë edhe institucionet të cilat janë anëtarë të rrjetit evropian për sigurimin e cilësisë në

arsimin e lartë ENQA, dhe duke u bazuar në konfirmimin që Agjencia për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditim në Austri është anëtare e plotë e këtij mekanizmi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "UBT";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Agency for
Quality Assurance
and Accreditation
Austria

The Agency for Quality Assurance and Accreditation Austria
awards its quality seal



to the Joint Master's Programme

Political Science – Integration and Governance (PoSIG)

to be implemented at the following Universities:

European University of Tirana (UET), Albania
University of Tirana (UTIR), Albania
University of Salzburg (PLUS), Austria
University of Sarajevo (UNSA), Bosnia and Herzegovina
Sarajevo School of Science and Technology (SSST), Bosnia and Herzegovina
FAMA College (FAMA), Kosovo¹
University of Business and Technology (UBT), Kosovo²
**Ss. Cyril and Methodius University in Skopje (UKIM), FYROM the Former
Yugoslav Republic of Macedonia**
University of Ljubljana (ULJU), Slovenia

The study programme complies with the "European Approach for Quality Assurance of Joint Programmes (2015)", approved by European Higher Education Area ministers in May 2015 in Yerevan (adopted by the Board of AQ Austria in its 36th meeting on 20th September 2016)

The accreditation is subject to conditions and is valid until 14th March 2023.

Vienna, 15th March 2017

Univ.-Prof. Dr. Anke Hanft
President of the Board of AQ Austria

Dr. Achim Hopbach
Managing Director of AQ Austria